


INFORMACIONE PÉR
PRINDER

Ethet



Ethet

Temperatura mesatare e trupit të një fëmije e matur sipas moshës është 37° Celsius. Temperatura e trupit nuk është kurrë konstante, ajo mundet sipas kohës së ditës të ndryshon deri 2 gradë Celsius (prej 36-38°C). Herët në mëngjes ajo është më e ulëta dhe herët në mbrëmje më e larta. Për ethe bëhet fjalë, kur temperatura e trupit të foshnjat nën 3 muaj e tejkalon 38°C dhe të fëmijët më të vjetër e tejkalon 38,5°C.

Ekzistojnë shkaqe të ndryshme për ethe. Shkaku më i shpeshtë i etheve në moshën e fëmijërisë janë infeksionet, të cilat shkaktohen nga viruset. Infeksionet virale nuk mund të trajtohen me antibiotikë, pasi që këta nuk kanë asnjë ndikim ndaj tyre. Ndonjëherë ethet shkaktohen edhe nga infeksionet bakteriale. Infeksionet me baktere mund të trajtohen saktësisht me antibiotikë. Në raste të rralla mund të shkaktojnë ethe edhe reaksionet alergjike, vaksinimet, sëmundjet kronike dhe shkaqe tjera të rralla.

Ethet nuk janë sëmundje, por është një shenjë e imunitetit mbrojtës të trupit. Ethet nuk janë të rrezikshme dhe lartësia e etheve nuk ka varësi me seriozitetin e sëmundjes aktuale.

Sa po të mundet infeksioni, menjëherë do të normalizohet temperatura e trupit.

Si të e matni temperaturën e fëmijës tuaj?

- Në rekomandojmë të foshnjat nën 12 muaj, matjen e temperaturës në After.
- Të fëmijët mbi 1 vjeçar temperatura mund të matet nën sqetull, në gojë nën gjuhë apo edhe në vesh me termometër veshi. Nëse ju nuk keni matur ethet kurrë deri tani, pyetni të këshillimi i nënave, mjekun tuaj apo farmacistin për udhëzime.

Foshnjat nën 3 muaj, të cilat kanë temperaturë mbi 38°Celsius, duhet të paraqiten menjëherë para mjekut.

Ethet mund të ngritën ngadalë por edhe shumë shpejt. Në raste të rralla pranë një infeksioni me ethe mund të vjen edhe deri të ngërçet e etheve. Ngërçet e etheve janë të rralla, dhe shfaqen në mes të 6 muajve dhe 5 viteve dhe nuk kanë pasojë me kohëzgjatje të madhe për fëmijët (krahajo me fletushkën për prindër mbi ngërçet e etheve).

Kur do të duhej të shkoni te mjeku juaj?

Ethet e larta mund të çojnë deri te ndikimi i gjendjes së përgjithshme të fëmijës tuaj. Kur fëmija juaj nga ethet e larta është i ndikuar në gjendjen e tij të përgjithshme (i zbutur, i lodhur, i irrituar, pinë pak):

- Zhvisheni fëmijën tuaj dhe visheni apo mbuloni lehtë
- Ethet e larta mund të çojnë deri te humbja e lëngjeve, për këtë arsye jepini shpesh sasi të vogla lëngjesh si ujë apo çaj
- Jepini Paracetamol në formë të qirinje apo sirup në sasi të llogaritur sipas moshës dhe sipas udhëzimeve të paketimit çdo 6 orë në ditë maksimalisht
- Vrojttoni rrjedhën: Ethet do të duheshin të ulen dhe gjendja e përgjithshme e fëmijës të përmirësohet. Nëse kjo nuk ndodh atëherë lajmëroni mjekun tuaj.
- Mos jepni Paracetamol më gjatë se 2 ditë çdo 6 orë pa e vizituar një mjek.

Nëse fëmija juaj i ka simptomat vijuese, ju do të duhej të shkoni te mjeku:

- Fëmija juaj është nën 3 muaj i ri dhe ka $\geq 38^{\circ}\text{C}$ Celsius ethe
- Fëmija juaj ka dhimbje koke dhe qafë të shtanguar dhe i pengon drita
- Fëmija juaj vjell vazhdimisht dhe nuk pranon të pinë
- Fëmija juaj ka zënie fryme
- Fëmija juaj bëhet gjithnjë e më tepër apatik, letargjik
- Fëmija nuk bëhet më mirë edhe përkundër dhënies së rregullt të Paracetamolit
- Fëmija juaj ka më tepër se 2 ditë ethe dhe ju i jepni çdo 6 orë Paracetamol
- Fëmija juaj ka ngërçe ethesh
- Fëmija juaj ka puçrra në trup në formë të pickimeve të pleshtave, të pa shtypshme, me pika / njolla të kuqe (krahaso fotografinë)

Petechiae



Stacioni i emergjencës Spitali i fëmijëve Zürich

Telefoni për këshilla: +41 58 387 78 80

Përmbledhje:

- Fëmijët kanë shpesh ethe. Shkaqet më të shpeshta janë infektimet me viruse
- Foshnjat nën 3 muajsh me ethe $\geq 38^{\circ}\text{C}$ duhet menjëherë të paraqiten te mjeku
- Ethet nuk janë as të dëmshme e as të rrezikshme porse shenjë, që trupi po mbrohet ndaj infektimit. Me rëndësi është vetëm e vetëm gjendja e fëmijës, e jo lartësia e etheve,
- Kur fëmija juaj është në një gjendje të përgjithshme të mire (ka dëshirë të luaj, duket i kënaqur) ju nuk duheni të i ulni gjithsesi ethet, pranë ndikimit në gjendjen e përgjithshme, te ethet ju mund të i jepni maksimalisht çdo 6 orë Paracetamol qirinj- apo në formë sirupi, të pritni dhe të e vrojtoni rrjedhën
- Gjithsesi do të duhej të lajmëroheni te mjeku në rast të etheve dhe simptomave të lartë përmendura apo kur ju ndiheni të pasigurt dhe jeni të merakosur për fëmijën tuaj